



KONFERENCA E PARË, 15.06.2017
“SHËNDETI I GJIMNAZISTËVE DHE STUDIME TË
INTEGRUARA
TË FUSHAVE BIOMJEKËSORE”
SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE “IBRAHIM KODRA”, DURRËS
LËNDA: QYTETARI

PROJEKT Nr. 18
Tema: “Ndotja e mjedisit”



Punoi: Iva ÇUNI
Xhensila SHEHU
Alket ÇAUSHI
Endi TRIÇO
Antea KERÇOVA
Doris JAKUPI
Denis DOMI

Udhëhoqi: Aida DUNISHA,
Albana SHYTI,
Laura GJYLI

Durrës, 2017

➤ Objektivat e Realizuara



- Ç'është mjedisi;
- Ç'janë ekosistemet;
- Llojet e ekosistemeve;
- Ekosistemet tokësore;
- Ekosistemet ujore;
- Biodiversiteti si koncept;
- Çfarë përfaqëson biodiversiteti;
- Humbja e biodiversitetit si problem global;
- Ç'është ndotja;
- Ndotja e tokës;
- Ndotja e ujit;
- Ndotja e ajrit;
- Shiu acid;
- Efekti serë dhe ngrohja globale;
- Masat parandaluese dhe mbrojtja e mjedisit;
- Të dhëna për ndotjen në Shqipëri.



➤ Ç'është mjedisi

Mjedisi apo *ambienti*, është tërësia e rrethanave përreth një organizmi ose grup organizmash, veçanërisht ndërthurja e kushteve të jashtme fizike, natyrore që veprojnë dhe ndikojnë në rritjen, zhvillimin, dhe mbijetesën e organizmave.




Në lidhje me njeriun dallojmë këto mjedise:

- mjedisi shoqëror,
- mjedisi kulturor dhe
- mjedisi natyror.


➤ Ekosistemi

- **Ekosistemi** është bashkësi aktive e biosferës, që përbëhet nga organizmat e gjalla, vendosur në një hapësirë të përcaktuar mirë. Në këtë hapësirë organizmat e gjalla janë të lidhura ngushtë midis tyre dhe me mjedisin fizik, në bashkëveprim të shumëllojshëm për shkëmbimin e energjisë e të lëndës.
- Në përbërjen e ekosistemit gjallesat si bashkësi quhen **biocenoze**, ndërsa lënda organike quhet **biotop**. Midis dy ekosistemeve shtrihet një zonë e cila karakterizohet nga tipare të përbashkëta të të dy ekosistemeve.
- Biosfera përbëhet nga miliona ekosisteme, prej të cilëve formohen rajone të ndryshme të gjeografisë së gjallesave (biogjeografi). Rajoni më vete përbën atë që quhet **biomë** në ekologji dhe zonë gjeografike në gjeografi.
- Gjallesat në një ekosistem janë disa llojesh. Secili lloj përbën një grup me vete, i cili ka edhe hapësirën e tij te jetës. Ndosht shpesh që hapësirat e jetës se grupeve e të llojeve, janë te ndërthurura me njëra-tjetrën.




➤ Llojet e ekosistemeve


- Ekosistemet janë bashkësi të formuara nga **BIOTIKËT** (qëniet dhe mjedisi i gjallë) dhe **ABIOTIKËT** (bota jo e gjallë).
- Ekosistemet në biologji ndahen në ekosisteme tokësore dhe ujore. Ekosistemet ujore përfshijnë 71,7 %, kurse ekosistemet tokësore përfshijnë 28,3 %.
- Në ekosistemet tokësore bëjnë pjesë :
 - ekosistemet e pyjeve,
 - ekosistemet e livadheve,
 - ekosistemet e kullotave,
 - ekosistemet e tundrave,
 - ekosistemet e stepeve,
 - ekosistemet e shkretëtirave,
 - ekosistemet e antropologjike (nga dora e njeriut).
- Ekosistemet ujore ndahen :
 - ekosistemet e ujërave të ëmbla, të kripura
 - ekosistemet e ujërave të njelmëta



BIOMAT TOKESORE




BIOMAT UJORE



➤ Biodiversiteti si koncept

- **Biodiversiteti** nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon apo në gjithë globin.
- Biodiversiteti paraqet llojshmërinë jetësore në tokë.
- Jeta e gjallë në tokë ka nivele të ndryshme të llojshmërisë duke filluar nga ADN-ja, llojet, popullacionet dhe ekosistemi.
- Sipas të dhënave shkencore në tërë botën deri me tani janë identifikuar 1.75 milion lloje.
- Ekzistojnë edhe miliona lloje të pafidentifikuara, shumica e të cilave gjenden në vendet tropikale (vlerësohet se numri i llojeve mundë të jetë mbi 5 milion).



Çfarë përfaqëson biodiversiteti

Tre elementet
kryesore:

1. Llojet ose speciet;
2. Ekosistemet e habitatet;
3. Burimet gjenetike.



➤ Humbja e biodiversitetit si problem global

- **Biodiversiteti** përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në botë.
- Është vlerësuar se rrjedha në këtë trend e kërcënimit të ekosistemeve natyrore do të paraqes rrezik për të ardhmen e njerëzimit dhe mund të sjell pasoja të rënda në natyrë.



Ndonëse kanë kaluar 14 vite që nga nënshkrimi i Konventës Ndërkombëtare për Biodiversitetin të mbajtur në Rio de Janeiro ku ndër parimet kryesore të miratuara ka qenë edhe “ruajtja e vitalitetit dhe shumëllojshmërisë biologjike të jetës në tokë dhe përdorimi racional i resurseve natyrore”, **problemi i ruajtjes së biodiversitetin vazhdon të jete edhe sot shumë i theksuar.**

➤ Ndotja si koncept

- **Ndotja** paraqet hedhjen e materialit kontaminues (ndotës) në mjedis.
- Ajo shkaktohet kryesisht nga aktivitetet e njeriut por edhe si rezultat i fatkeqësive natyrore.
- Ndotja ka ndikim dëmtes në çfarëdo organizmash të gjallë në mjedis, duke e bërë praktikisht të pamundur qëndrueshmërinë e jetës.



➤ **NDOTJA E TOKËS**

• Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore.

• **Faktorët që ndikojnë janë:**

- a. Te njëjtët faktorë që ndotin ujin e ajrin e ndotin edhe tokën.
- b. Rreziku nga humbja e shtresës së siperme që perdoret prej njeriut për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë. Humbja e saj vjen nga fenomeni i shpyllëzimit, erozionit, ndryshimit të temperaturave etj.



Parandalimi:

- a. menaxhimi i mbeturinave,
- b. shfrytëzimit të tokës në mënyrë adekuate
- c. praktikave adekuate bujqësore.

➤ **NDOTJA E UJIT**

- **Ndotja e ujit** paraqet hedhjen e materieve kimike, biologjike dhe fizike në sasi të mëdha uji , të cilat shkatërrojnë cilësinë e botes se gjallë në to.
- Burimet ujore, po preken si nga faktorë shoqërorë ashtu edhe nga faktorë natyrorë.
- Nder faktorët natyrorë janë: kalimi i ujit në sipërfaqe ose në thellësi duke u përzier me ujrat e ndotura etj.



- Nder faktorët shoqërorë mund të përmendim ndotja qe vjen nga perdorimi i kimikateve, derdhja e mbeturinave, derdhja e naftes etj.
- **Pasojat:**
 - a. zhdukja e gjallesave të ndryshme të ujit;
 - b. mospërdorimi për nevojat jetike të ujit;
 - c. përhapjen e sëmundjeve infektive.
- **Parandalimi:** Të mos hedhim mbeturina dhe materie të tjera kimike të dëmshme në burimet tona të furnizimit me ujë.

➤ NDOTJA E AJRIT

- **Ndotja e ajrit** paraqet grumbullimin e atyre substancave të rrezikshme në atmosferë të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve dhe të gjallesave të tjera.
- Zhvillimi i industrisë dhe përdorimi i makinave bën që ajri që ne thithim të jetë mjaft i ndotur sidomos në zonat urbane ku është e përqëndruar edhe popullsia më e madhe.




- Ka disa mjedise pune si në shkrirjen e metaleve, në degete të industrisë ku përdoren kimikate etj, ku shkalla e ndotjes së ajrit është shumë e lartë dhe rrezikon shëndetin e punetoreve dhe të banorëve përreth
- Burimet kryesore që kanë ndikuar në rritjen e ndotjes së ajrit janë: djegia e mjeteve të transporteve dhe djegia pa rregullë e mbeturinave.
- Mënyra më e mirë për parandalimin e ndotjes së ajrit është të ecim këmbë ose të ngasim biçikletën dhe të ngasim makinat më pak. Kjo do të parandalojë ndotjen e ajrit nga lëndët djegëse fosile


➤ Shiu acid

- **Shiu acid** është një lloj shiu ose çdo formë tjetër reshjeje që ka nivel të pazakontë aciditeti, çka do të thotë se ka nivel të lartë të joneve të hidrogjenit (pH i ulët).
- Mund të shkaktojë efekte të dëmshme mbi bimë, kafshët ujore dhe infrastrukturë.


Reaksionet e acideve sulfurike:




Krijimi i acidit sulfuror:



Krijimi i acidit sulfurik nga acidi sulfuror:



Krijimi i acidit nitrik:



- Shiu acid shkaktohet nga emetimi i dioksidit të squfurit dhe oksidi i azotit, të cilët bashkëveprojnë me molekulat e ujit në atmosferë duke krijuar acide.
- Kimikatet në shiun acid mund të shkaktojnë heqjen e bojës, gërryerjen e strukturave të çelikut tek urat dhe erozion të statujave prej guri.



Efekti serë dhe ngrohja globale

- Efekti serë është një proces i natyrshëm që ngroh sipërfaqen e Tokës. Kur energjia e Diellit arrin atmosferën e Tokës, një pjesë e saj reflektohet në hapësirë dhe pjesa tjetër ri-absorbohet nga gazet atmosferik (**gazit serë**) si: avulli i ujit, dioksidi i karbonit, metani, oksidi i azotit etj. Energjia e përthithur ngroh atmosferën dhe sipërfaqen e Tokës. Ky proces mban temperaturën e Tokës në rreth 33°C më të ngrohtë se sa do të ishte ndryshe, duke lejuar që jeta në Tokë të ekzistonte.

➤ Pasojat e ngrohjes globale

- Ndryshimet e temperaturës;
- Shkrirja e akujve në pole;
- Rritja e niveli të detit;
- Rritje dhe intensifikim i reshjeve të shiut dhe dukurive negative të tija siç janë përmbytjet;
- Mungesa e ujit të freskët;
- Me rritjen e temperaturës së ujërave të oqeanëve, aftësia e tyre për të thithur CO₂ zvogëlohet;
- Sasia e oksigjenit të tretur në ujërat oqeanike mund të zvogëlohet;
- Vdekja e njerëzve nëpër botë nga disa lloje sëmundjesh: 3% nga diarreja, 3% nga malaria, 3.8 % nga ethet tropikale;
- Ekosistemet do të ndryshojnë. Disa specie do të zhvendosen për më në veri ose do të përshtaten dhe të fitojnë imunitet dhe të tjera specie nuk do të mund të zhvendosen dhe do të zhduken.;
- Ndryshimet klimatike do të ndikojnë në bujqësi dhe në prodhimin ushqimor

E f e k t i S e r e

DIELLI

Nje pjese e rrezatimit diellor reflektohet nga Toka dhe atmosfera

Nje pjese e rrezatimit infra te kuq kalon permes atmosferes dhe nje pjese absorbohet dhe rriemtohet ne te gjitha drejtimet nga molecular e efektit sere. Rezultat I kesaj eshte ngrohja e siperfaqes se Tokes dhe e atmosferes se ulet


Rrezatimi diellor kalon permes atmosferes se paster

Atmosfera

Toka

Pjesa me e madhe e rrezatimit absorbohet nga siperfaqja e Tokes dhe e ngroh ate

Rrezatimi infra i kuq emetohet nga siperfaqja e Tokes



➤ Masat parandaluese dhe mbrojtja e mjedisit

Këto janë disa rregulla bazike, aplikimi i të cilave ndikon në uljen e ndotjes mjedisore



1. **Hidhni mbeturinat në shportë, jo në vende publike!**
2. **Uji është i çmueshëm, mos e lini të rrjedhë pa nevojë!**
3. **Fikeni dritën** kur nuk është askush në dhomë!
4. **Veturat ndotin ajrin, rrugëve të shkurtra ec ose shfrytëzoje biçikletën!**
5. **Mbillni pemë, shumë pemë, të paktën një gjatë jetës suaj!**
6. **Përdorni poçe elektrike që kursejnë rrymën, këto harxhojnë më pak energji dhe kanë jetë më të gjatë se ato të zakonshmet!**
7. **Përdorni qese të tekstilit gjatë blerjeve, ato mund të përdoren shumë herë dhe zëvendësojnë qeset e plastikës!**

Këto të fundit kanë ndikim të madh negativ në mjedis.



Ndotja ne Shqipëri

- **Ndotja e ajrit.** Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore mjedisore në qytetet e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë. Ndotja ka ardhur për pasojë e shtimit të makinave dhe pakësimit të gjelbërimit urban.
- **Ndotja e ujit.** Ndotja e ujërave në Shqipëri vjen si pasojë e hedhjeve të mbeturinave në lumenj e liqene, si dhe derdhjes së ujërave të zeza të papërpunuara.
- **Shpyllëzimi.** Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri.
- **Ndryshimet klimatike.** Ndryshimet klimatike kanë prekur në mënyrë të konsiderueshme Shqipërinë. Rritja e nivelit të detit ka çuar në zhdukjen e disa metrave tokë në bregdet në vit. Gjithashtu, zjarret janë bërë më të shumta në numër për shkak të temperaturave të larta në verë.



Bibliografia

- www.onepercentfortheplanet.org
- https://www.google.al/search?q=ENVIRONEMENT&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjzgLem97LUAhwKfFAKHcoFCpsQ_AUICigB&biw=1920&bih=925#imgrc=phqoQLJëzwVyLM:
- https://www.google.al/search?q=ENVIRONEMENT&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjzgLem97LUAhwKfFAKHcoFCpsQ_AUICigB&biw=1920&bih=925#imgrc=PVS7eiaeo9WCbM:
- https://www.google.al/search?q=ENVIRONEMENT&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjzgLem97LUAhwKfFAKHcoFCpsQ_AUICigB&biw=1920&bih=925#imgrc=MyLNR- WLoo-HM:
- www.maroc.ma/en/content/environnement
- <https://en.Wikipedia.org/Wiki/Pollution>

Faleminderit për vëmendjen!

